



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
BORDI MBIKQYRËS

Nr. 141/L Prot.

Tiranë më, 19.02.2024

PROÇES-VERBAL

MBI MBLEDHJEN E BORDIT MBIKQYRËS

Bazuar në Ligjin Nr. 10093 datë 09.03.2009, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, VKM-së Nr. 769, datë 15.07.2009 “Për Miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, e ndryshuar dhe “Rregullores mbi Proçedurat e Financimit me Grant në Mbështetje të Shoqërisë Civile”, sot më datë **19.02.2024 në orën 12:00**, në ambjentet e selisë të AMSHC-së me adresë Rr. “Frosina Plaku” Nr.58, Kati 2, Godina e Observatorit, Tiranë, u zhvillua mbledhja e Bordit Mbikqyrës dhe u trajtua rendi i ditës si më poshtë:

1. Miratimi i propozimeve të ndryshimeve të “Rregullores mbi Proçedurat e Financimit me Grant në Mbështetje të Shoqërisë Civile”.
2. Prezantimi i propozimeve të prioriteteve të Thirrjes 17 propozuar nga aktorët e Shoqëria Civile.
3. Mbi proçesin e Shpalljes së Thirrjes së rradhës të AMSHC-së;

Në mbledhje të pranishëm ishin 8 anëtarë të Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së si më poshtë:

1. Znj. Iris Luarasi – Kryetare e Bordit Mbikqyrës
2. Znj. Elira Kokona – Anëtar
3. Znj. Esmeralda Selita – Anëtar
4. Z. Bashkim Muça – Anëtar
5. Z. Ylljet Aliçka – Anëtar
6. Znj. Eridana Cano – Anëtar
7. Z. Laert Kola – Anëtar
8. Z. Oltjon Muzaka – Anëtar

Gjithashtu i pranishëm nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ishte:

1. Z. Andi Kananaj –Drejtor Ekzekutiv

Fjalën e hapjes e mori Z. Andi Kananaj, Drejtori Ekzekutiv, i cili ju paraqiti pjesëmarrësve në mbledhje rendin e ditës dhe çështjet për trajtim të cilat ju parashtuan Bordit Mbikqyrës dhe në



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
BORDI MBIKQYRËS**

formë të bazës material shkresore, material me të cilat janë prezantuar dhe më herët ndërmjet komunikimeve elektronike (korrespondencë me e-mail).

Antarët e Bordit Mbikqyrës, pasi u njohën në parim me materialet dhe dokumentat e prezantuara nga Drejtorit Ekzekutiv, miratuan në parim dhe nen për nen ndryshimet e propozuara të *"Rregullores mbi Procedurat e Financimit me Grant në Mbështetje të Shoqërisë Civile"* dhe gjithashtu pasi shqyrtuan propozimet për prioritetet analizuan ato dhe konkluduan se **prioritetet për Thirrjen 17** do të jenë si më poshtë:

1- Forcimi i drejtësisë dhe llogaridhënies: qasje novatore në monitorimin e reformes në drejtësi dhe rritjen e rolit të mediave investigative në luftën kundër korrupsionit.

- Korrupsioni dhe lufta kunder tij
- Monitorimi i Reformes në drejtësi dhe procesit të vettingut
- Mbështetje për median investigative lokale

2- Fuqizimi i Gjeneratës së ardhshme: Nxitja e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve përmes promovimit të talenteve artistike, integritetit në komunitet, vullnetarizmit dhe ndërgjegjësimit për shëndetin seksual.

- Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve
- Bashkeveprimi i rinisë në fushatat sensibilizuese për promovimin e talenteve të reja në art dhe trashëgimi kulturore
- Aktivizimi i të rinjve në proceset integruese, vullnetarizmi dhe filantropia
- Sensibilizimi i të rinjve për marrëdhënie të mbrojtura dhe të shëndetshme seksuale

3- Rritja e mirëqenies së komunitetit përmes qeverisjes lokale gjithëpërfshirëse: Forcimi i qeverisjes vendore, edukimi profesional dhe shërbimet sociale për gratë, të rinjtë, të moshuarit, minoritetet dhe njerëzit me aftësi të ndryshme.

- Mirëqeverisja vendore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE BORDI MBIKQYRËS

- Mbështetje për arsimimin profesional, fuqizimin dhe punësimin e grave e të rinjve.
- Përmirësimi i shërbimeve sociale.
- Mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë, etj.
- Mbështetja e minoriteteve, regjistrimi i fëmijëve rom në regjistrat e Gjendjes Civile.
- Mbështetje dhe aksesueshmëria për personat me aftësi ndryshe, përfshirja sociale e personave me aftësi intelektuale.

4- Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Mbrojtja e Mjedisit: Rritja e Zonave Natyrore Rajonale për Turizmin, Mbështetja e Ruajtjes së Pyjeve dhe Burimeve Termale, Promovimi i Turizmit Familjar me fokus në produktet tradicionale përballë kërcënimit të zhvillimit ekonomik.

- Identifikim, adresim dhe zhvillim të zonave rajonale natyrore me potenciale turistike të riskuara nga zhvillimet ekonomike të pakontrolluara.
- Mbështetja e projekteve për mbrojtjen e mjedisit me fokus pyjet dhe vendburimet termale; Fokusim dhe adresim i dëmeve të shkaktuara gjatë tranzicionit dhe në vijim në hapësirat detare dhe bregdetare shqiptare.
- Zhvillimi i turizmit dhe kryesisht atij familjar duke pasur parasysh prodhimet tradicionale të zonës.

5- Forcimi i themeleve të Integritetit Evropian: Rritja e Demokracisë dhe Fuqizimi i Shoqërisë Civile

6- DimENSIONI DIGJITAL PËR DHUNËN NDAJ GRAVE

❖ Shuma maksimale e financimit me grante do të jetë 2, 000, 000 (dy milion) lek.

Në mbledhje u diskutua dhe procedura e hapjes dhe publikimit të Thirrjes 17 dhe është ngarkuar AMSHC për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha mekanizmave për publikimin dhe afishimin e Thirrjes (në media të shkruara dhe web-in zyrtar të AMSHC-së), sipas mënyrës që ligji në fuqi parashikon.

Në përfundim pas analizës së bërë si më sipër, Bordi Mbiqyrës përmbledhi dhe çështjet e diskutuara në rendin e ditës dhe **vendosi** :



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
BORDI MBIKQYRËS

1-Përpilimin e Vendimit në përmbajtjen e të cilit të përfshihen të gjitha pikat e vendosura në mënyrë unanime nga BM.

Vendimi i miratuar nga Bordi Mbikqyrës, është pjesë e pandashme e këtij proces-verbali.

I mbajtur sot më datë, 19.02.2024

Konceptoi: A.Ndreka